

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË
FEDERATËS SE KARATESË SE KOSOVËS

Prishtine, 2021

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit të FKK-së dhe një ndër obligimet prioritare janë:

- ✚ **Përgatitja dhe konvokimi i Kuvendit,**
- ✚ **Udhëheqja me mbledhjet e Kuvendit,**
- ✚ **Mënyra e aprovimit të konkluzave dhe vendimeve,**
- ✚ **Informimi për punën e Kuvendit dhe**
- ✚ **Mbajtja e procesverbaleve dhe punëve të tjera lidhur me punën e Kuvendit.**

Neni 2

Seanca e rregullt e Kuvendit mbahet dy herë në vit, e më së paku një herë në vit.

Neni 3

Në Kuvend mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Federatës së Karatesë së Kosovës, mysafir dhe përfaqësuesit e ftuar të mjeteve të informimit.

Seanca e Kuvendit mund të mbahet edhe me dyer të mbyllura, për të cilën vendosë Kuvendi, në bazë të propozimit të Kryetarit.

Përgatitja dhe konvokimi i Kuvendit

Neni 4

Seancat e Kuvendit i përgatitë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Materialin e përgatitur për seancë e shqyrton dhe e miraton edhe BORD-i.

Neni 5

Propozimin e rendit të ditës e paraqet Kryetari, pas miratimit në Bordin Ekzekutiv të FKK-së.

FKK 2021

Rendi i ditës mund të plotësohet nga anëtarët e Kuvendit.

Rendi i ditës aprovohet në seancën e Kuvendit.

Neni 6

Seancat e Kuvendit konvokohet me iniciativën e:

- ❖ **Kryetarit të Kuvendit dhe**
- ❖ **50% + 1 e anëtarëve të Kuvendit**

Mbledhja konvokohet me shkrim ku shënohet data, koha dhe vendi i mbajtjes së Kuvendit dhe propozimi i rendit të ditës.

Ftesën me shkrim për Kuvend e nënshkruan Kryetari apo konvokuesi i Kuvendit, si është paraparë në alinenë një të këtij neni.

Udhëheqja e Kuvendit

Neni 7

Seancën e Kuvendit e hapë dhe e udhëheqë Kryetari. Në mungesë të Kryetarit, seancën e Kuvendit mund ta udhëheqë ndonjëri nga nenkryetaret e Federates ose një nga anëtarët e Kuvendit të cilin paraprakisht e cakton Kryetari me shkrim.

Për mirëvajtjen e punës së Kuvendit, kryesuesi mund t'i shqiptoi këto masa:

- ❖ *vërejtje,*
- ❖ *t'i merret fjala e diskutimit,*
- ❖ *ta largoi nga mbledhja e Kuvendit, për të cilën masë nevojitet shumica e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.*

Neni 8

Seanca e Kuvendit mund të mbahet nëse në të prezantojnë më tepër se gjysma e anëtarëve të Kuvendit (50+1).

Pas konstatimit se ekziston numri i anëtarëve për mbajtjen e seancës, Kuvendi e aprovon rendin e ditës.

Çdo anëtarë i Kuvendit ka të drejtë të propozoi plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar atë.

Neni 9

FKK 2021

Seanca e Kuvendit zgjatë më së shumti 4 orë. Diskutimi për çdo pikë të rendit të ditës kufizohet në tre minuta, kurse replika në një minuta.

Neni 10

Në Kuvend marrin pjesë anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e DKRS-ë, anëtarët të deleguar nga KOK dhe mysafirët dhe përfaqësuesit e ftuar të mjeteve të informimit, të cilën e përcakton BORD-i, varësisht nga karakteri i seancës (a është Kuvend pune apo zgjedhor).

Dispozitat përfundimtare

Neni 11

Rregulloren e aprovon Kuvendi i cili gjithashtu ka të drejtën e plotësimit dhe ndryshimit të sajë.

Hyrja në Fuqi

Neni 12

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së dhe nënshkruar nga Kryetari i Federatës së Karatesë së Kosovës.

Prishtinë, 19 Qershor 2021

Ismet Krasniqi

Kryetar

